



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODEUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ II UROŠEVAC

Më
 Dana 08.02.2019

C.nr. 936/18

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtari Misin Frangu me sek.juridike Albana Ajvazi, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit [redacted] nga Ferizajt rr." [redacted] ".pn. të cilin e përfaqëson [redacted] avokat nga Ferizaj, kundër të paditurëve [redacted] nga Ferizaj rr." [redacted] , pn. dhe [redacted] nga fsh [redacted] Komuna Ferizaj, tani me adres të panjohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm [redacted] nga Ferizaj avokati, baza e kontestit vërtetim i të drejtës së pronësisë, e pas mbajtjes së seancës gjyqësore, me datë 08.01.2019, merr këtë:

AKTGJYKIM

I.APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësit [redacted] nga Ferizajt rr." [redacted] ".pn, dhe i njihet e drejta e pronësisë në ngastër kadastrale-njësinë me nr. 281-1 në vendin e quajtur " Lamet ", lloji i njesis parcel, lloji i pronës private, zona U/R, lloji i shfrytzimit bujqësore shfrytzimi aktual i parces arë, kualiteti i klasa 3, në sipërfaqen e përgjithshme prej 318 m2, certifikatës së pronës të datë 20.12.2018 , Zona Kadastrale Ferizaj , në bazë shitblerjes - mbajtëses.

DETYROHET, të paditurit [redacted] nga Ferizaj rr." [redacted] ", pn. dhe [redacted] nga fsh [redacted] Komuna Ferizaj, tani me vendbanim të panjohur të i'a njohin të drejtën e pronësisë paditësit [redacted] dhe të lejojnë që ngastrate lartpërmendur të regjistrohet në emër të tij.

DETYROHET Drejtoria për Kadastër, Pronësi dhe Gjeodezi në Ferizaj, që të bëjë ndryshimin në bazë të këtij Aktgjykimi.

II.OBIGOHET paditësi tia paguj shpenzimet e procedurës, përfaqësuesit të përkohshëm avokat [redacted] , për katër seanca nga 270.00 €, për dy seancat e shtyra nga 135.00 €, si dhe për pergjegjen në padi shumen prej 104.00 €, e shuma e përgjithshme për pagës 1.454.00 €.

III. Shpenzimet e procedurës do ti heqë paditësi, dhe taksen për padi shumen prej 100.00 €.

Arsyetim

Paditësi ka ushtruar padi me shkrim me datë 02.12.2015, pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj me bazën juridike vërtetimi i të drejtës së pronësisë në bazë të shitblerjes dhe mbajtjes.

Në seancën pregatitore me datë 31.05.2016, përfaqësuesi i paditësit avokati [REDAKTUAR] meqë të padiures nuk i dihet adresa e banimit, përfaqësuesi i paditësit gjatë seancës pregatitore i ka propozuar gjykatës që të paditurës ti caktohet përfaqësuesi i përkohshëm. Lidhur me propozimin e përfaqësuesit të paditësit gjykata ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për të aprovuar propozimin e tillë dhe me aktvendim C.nr.829/15 të datë 01.06.2016 të paditurit i ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm avokatin [REDAKTUAR] nga Ferizaj. Po ashtu përfaqësuesi i paditësit i kërkuar nxerrjen e provës dhe vërtetimin e gjendjes faktike përmes ekspertit të gjeodezisë si dhe ka propozuar që të dëgjohen dëshmitaret, të cilat kërkesa janë aprovuar nga Gjykata si të bazuar.

Përfaqësuesi i paditësit në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkespadiës duke vazhduar se nga provat e administruara në seancën e sotme dhe seancat e kaluara si dhe nga dëshmia e dëshmitareve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] si dhe nga deklarata e të paditurit [REDAKTUAR] është vërtetuar se paditësi në vitin 1985 e ka blerë nga të paditurit ngastren kadastrale me nr.281-1 pjesën në sipërfaqe prej 318 m², dhe i njëjti e ka pasur në posedim nga dita e blerjes e deri me sotë, i ka propozuar gjykatës që të aprovoj kërkespadien e paditësit dhe të vërtetojë se paditësi është pronar i ngastres kadastrale me nr.218-16, në sipërfaqe prej 318 m² ZK.Ferizaj.

I padituri i parë [REDAKTUAR] në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk është kontestuese se ngastra kadastrale e cila është objekt kontesti është shitur nga babai im rreth 40 vite më parë, i ka propozuar gjykatës që paditësit ti a njeh të drejtën e pronësisë në këte ngastër, sepse paditësi këte ngastër kadastrale e ka blerë dhe shfrytëzon pa u penguar nga askush deri me tani dhe njëjtit e ka në posedim të qetë këte palujtshmeri.

Përfaqësuesi i përkohshëm avokati [REDAKTUAR] ka deklaruar se mbetet si në përgjigjeje në padi duke e kundërshtuar kërkespadien e paditësit dhe ka rezervuar të drejtën që pas adminidtrimit të provave të deklarohet për këte çështje juridiko-civile kontestimore, ndërsa në fjalën përfundimtare ka mabatur në tërësi si në seancat mbajtura në këte gjyaktë, duke vazhduar se u vëtetua se padia e paditësit është e bazuar e sidom nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], edhe vet pranimi i të paditurit të parë [REDAKTUAR] shifet se ngastra kadastrale 281-1, e që pas coptimin të kësaj ngastren e paditësit [REDAKTUAR] e ka blerë një pjesë të kësaj ngastre dhe atë ngastren me nr.218-16, në sipërfaqe prej 318 m² ZK.Ferizaj.

Pas deklarimeve të palëve ndërgjyqëse gjykata në seancën gjyqësore të datës 08.01.2019, ka ndëgjuar ekspertin e gjeodet [REDAKTUAR] ashtu siq kërkohet edhe me dispoziten e nenit 362 të LPK-së, i cili ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë ekspertizës së punuar me shkrim.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarit ka dëgjuar [REDAKTUAR] i cilin identifikohet me nr.1500694013, lëshuar nga MPB-Republika e Kosovës, i cili ka deklaruar se paditësi në këtë shtëpi jeton që nga viti 1985 dhe që nga ajo kohe është në posedim të kësaj palujtshmeri.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarit ka dëgjuar [REDAKTUAR] i cilin identifikohet me nr.1011553733, lëshuar nga MPB-Republika e Kosovës, i cili ka deklaruar se paditësi këtë pronë e ka blerë që nga viti 1980-85, e ka paguar në tërësi çmimin kontraktues dhe menjëherë ka hyrë në posedim të kësaj palujtshmerie, ka ndërtuar shtëpinë ku edhe sot jeton në këtë shtëpi.

Me qëllim të vërtetimit plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për atë sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për të parashtruar provat dhe faktet e çështjes, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, kishte administruar edhe provat si në vijim, ka lexuar kopjen e planit të datë 04.09.1982, përgjigjën në padi nga ana e AKP-së, e datë 13.06.2016, Ref.nr.00639/16/vd, procesverbalin e vendit të ngjarjes të datë 17.07.2016, aktvendimin me shenjen C.nr/829/15 i datë 15.10.2017, raportin e punuar nga eksperti gjeodet [REDAKTUAR] datë 10.12.2018. certifikata në emër të pronës P-72217092-0281-1, Yona Kadastrale Ferizaj, e datë 20122018 në emrin e [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] parashtrësja e datë 25.10.2018, aktvendimi i trashëgimis T.nr.57/06 i datë 14.03.2006.

Gjykata duke u bazuar në neni 8 të LPK-së veçoj provat veç e veç. certifikatën e pronës për ngastrën kadastrale-njësine nr. P-72217092-00281-1, ZK.Ferizaj, dëshmojnë se padia përputhet plotësisht në subjektin si pale kontestuese. Ekspertizën dhe plotsimin ekspertizës nga ana e ekspertit të gjeodezisë tregon përputhshmërinë e kërkesëpadisë me gjendjen reale dhe faktike në terren si dhe gjendjen aktuale, mbi shfrytëzimin e kësaj ngastre kadastrale dhe kontestuese deri me tani. Ngastra kadastrale pas matjeve nga ana e gjeodetit vërtetohet se nga pika 1. E deri në pikën 7 ka një gjatësi prej 10.1 m, nga pika nr.1 e deri te pika nr.2 ka një gjatësi prej 3.44 m, nga pika nr.2 deri te pika nr.3 ka një 26.97 m, nga pika nr.3 e deri te pika nr.4 me një gjatësi prej 11.05 m, dhe nga pika nr.4 e deri te pika nr.5 ka një gjatësi prej 6.18 m, nga pika nr. e deri te pika nr.6 kemi një gjatësi prej 5.23 m, dhe nga pika nr.6 e deri te pika nr.7 kemi një gjatësi prej 18.46 m. në sipërfaqe prej 318 m2 ka marrë numrin 281-16, sipas ekspertizës të punuar nga gjeodeti [REDAKTUAR]. Si dhe deklaratat e dy dëshmitarëve të dhanuna në shqyrtimin kryesor e forcon kërkuesin e paditesit në njërin anë dhe besimin e Gjykatës për ndodhjen e punës juridike. Përgjigja nga AKP-ja se vërtetë për këtë ngastër kadastrale askush nga personat fizik dhe e as nga ata juridik nuk ka paraqitur kërkesë lidhur me këtë ngastër kontestuese.

Gjyaka ka vërtetuar se paditësit [REDAKTUAR] dhe në mes të paditurëve ka egzistuar raportin juridik i cili edhe pse nuk kishte lidhur kontrat me shkrimin ka prodhuar efekt juridik, me faktin se kishte ndodhur trasankcioni në mes tyre si shitësëve dhe blerësit.

Këte rapor juridik paditësi e materialozon duke hy në posedim të pa ndërprerë dhe të pa penguar nga askush që nga viti 1985 ku dhe kishte paguar çmimin në tëresi.

Gjykata nga e drejta material konstaton se janë përmbushur kushtet nga neni 18 i LMD-së si dhe nga neni 36 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat tjera Sendore, si dhe neni 28 parag.4 I Ligjit mbi Mardhenjet Pronsore Juridike i shpalle në G.Zyrtare të RSFJ" nr.6/80 dhe 37/90 të cilen raport edhe sot e legalizon dhe ligjitimon neni 40 parag 1 i Ligjit për të Drejtat Sendore nr.03/L-154 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Andaj Gjykata duke u bazuar në gjitha keto prova dhe fakte të pakontestueshme duke qenë i pavarur në vendosje, miratoi kërkespadin e paditesit.

Shpenzimet e procedures do ti bartë paditësi [REDAKTUAR] në pajtim me nenin 467 i LPK-së. E ka detyruar që paditësi tia paguj shpenzimet e procedurës, përfaqësuesit të përkohshëm avokat [REDAKTUAR] për katër seanca nga 270.00 €, për dy seancat e shtyra nga 135.00 €, si dhe për pergjegjen në padi shumen prej 104.00 €, e shuma e përgjithshme për pagës 1.454.00 €.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
C.nr. 936/18 Më datë .08.01.2019

Gjyqtari
Misin Frangu



KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.